



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 104, Datë 30.04.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E “METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT”

Në mbështetje të neneve 16; 19, gërma “b”; 20, gërma “a”; 86, pika 6 dhe 87, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave në lidhje me rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin nr. 201, datë 04.12.2017 të Bordit të ERE-s,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, në zbatim të nenit 87, pika 4 të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me vendimin nr. 201, datë 04.12.2017, miratoi “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”.
- Kjo Metodologji u hartua në kushtet kur:
 - Nuk kishte një ndarje të llogarive midis aktivitetit të furnizimit e shpërndarjes së energjisë elektrike me qëllim përcaktimin e saktë të shpenzimeve operative për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, një pjesë e të cilave duhet tu alokohen klienteve të FMF.
 - Nuk ekzistonte brenda OSHEE sh.a. një strukturë e posaçme e cila do të evidentonte kostot e administrimit dhe kostot e disbalancave të cilat shkaktohen nga klientët që janë në kushtet e furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
 - Ky furnizues nuk kishte filluar akoma të operonte dhe që pritej të furnizonte klientët për jo më shumë se 60 ditë.
- Ndarja e OSHEE sh.a. dhe krijimi i tre shoqërive të reja aksionere: Furnizimi i Shërbimit Universal sh.a., Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. do të krijojë kushtet për përcaktimin më të qartë të detyrave edhe

ndarjen e kostove për çdo shoqëri duke mundësuar përcaktimin e qartë të shpenzimeve operative/administrative për çdo kWh të furnizuar nga FSHU që më tej çon në përcaktimin e qartë të kostove për FMF.

- Neni 3 i Ligjit nr. 7/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, amendoi nenin 86 të Ligjit nr. 43/2015 duke përcaktuar se: “Klienti fundor që furnizohet nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe që në kuptim të nenit 109, të këtij ligji, del për herë të parë në treg të liberalizuar, është i detyruar të lidhë një kontratë furnizimi me një furnizues të ri, brenda 2 viteve nga fillimi i kontratës së furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit. Në përfundim të kësaj periudhe, operatori i sistemit ndërpret furnizimin me energji elektrike të këtij klienti.
- Zgjatja e afatit të shërbimit për klientet e FMF nga 60 ditë në 2 vjet krijon mundësinë për furnizuesin e FMF të parashikimit dhe planifikimit të sasisë së energjisë së blerë për një periudhë afatgjatë dhe me çmime të favorshme. Për këtë arsye mund të shikohet mundësia e përcaktimit të çmimeve afatgjata (vjetore) me të drejtë axhustmi të të ardhurave në periudhën pasardhese.
- Së fundmi, në zbatim të nenit 109 dhe nenit 86 të amenduar të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, me qëllim nxitjen e hapjes së tregut, çdo çmim i aplikur nga FMF tek klientët e shërbyer prej tij, më i ulët se çmimi i përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr.148, datë 26.12.2014, nuk do të shërbente këtij qëllimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rishikimin e nenit 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” miratuar me vendimin nr. 201, datë 04.12.2017 të Bordit të ERE-s, si vijon:

Ishte :

Neni 8

Llogaritja e Çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit Llogaritja e çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, do të bëhet sipas formulës së mëposhtëme:

$$\text{ÇFMF}_t = \text{KDFP}_t + \text{CBE}_t + \text{TRrTSH}_t)$$

Ose:

$$\text{ÇFMF}_t = \text{CBE}_t + 10\% \text{CBE}_t + \text{TRrTSH}_t)$$

Ku:

CFMFt - Çmimi i furnizimit në periudhën relevante t

KDFPt - Kosto Direkte e Furnizimit me Pakicë sipas pikës 6 të nenit 6

Ku:

*KDFPt - është 10% *CBEt*

CBEt Çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit

TRrTSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për periudhën relevante t.

Bëhet:

Neni 8

- 1. LLogaritja e Çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit Llogaritja e çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, do të bëhet sipas formulës së mëposhtëme:*

$$\text{ÇFMFt} = \text{KDFPt} + \text{CBEt} + \text{TRrTSHt}$$

$$\text{Ose: } \text{ÇFMFt} = \text{CBEt} + 10\% \text{ CBEt} + \text{TRrTSHt}$$

$$\text{ÇFMFt} = \text{CBEt} + \text{Pr} * \text{CBEt} + \text{TRrTSHt} + \text{CA}$$

Ku:

CFMFt - Çmimi i furnizimit në periudhën relevante t

KDFPt - Kosto Direkte e Furnizimit me Pakicë sipas pikës 6 të nenit 6

Ku:

*KDFPt - është 10% *CBEt*

CBEt Çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit (Tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me preparesi (BRE))

TRrTSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për periudhën relevante t

Pr – Kthim per riskun i percaktuar per vitin

CA- Kosto administrative te Furnizuesit te Mundesise se Fundit percaktuar sipas nenit 6 te kesaj metodologjie.

Pas pikës 8.1, shtohet pika 2 me përmbajtje si më poshtë:

2. *Në çdo rast ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i shitjes me pakicë te klientët që furnizohen në atë nivel tensioni sipas Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014.*
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI